



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

**Komuna e Prishtinës**  
Opština Priština -Municipality of Prishtina



Në mbështetje të nenit 52, paragrafi 52.1 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28 / 15, qershor 2008), dhe të nenit 45 paragrafi 45.2 i Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa të Komunës së Prishtinës

**th e r r e t**

mbledhjen e **parë** të Komitetit për Politikë dhe Financa, e cila do të mbahet më **19.02.2014**, dhe do të fillojë në orën **15:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e Këshillit të Drejtorëve (kati II) të Komunës së Prishtinës. Për mbledhje propozon këtë

**REND DITE:**

1. Propozimi i Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2014;
2. Propozimvendimi për formimin e Komitetit për Komunitete;
3. Caktimi i anëtarit në komisionin komunal të aksionarëve në ndërmarrjet publike lokale;
4. Propozimvendimi për vazhdimin e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës AKP-së;
5. Propozimvendimi për caktimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës;
6. Propozimvendimi për shitjen e pronës së luajtshme të Komunës;
7. Informatë për suksesin e nxënësve në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2013 / 2014;
8. Propozimvendimi për lejimin e mjeteve NPK "Trafiku Urban" SH.A. Prishtinë;
9. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Memorialit në shenjë nderimi për kontributin e gruas gjatë periudhës së Luftës 1998 - 1999;
10. Propozimvendimi për ndryshimin e Statutit të teatrit të qytetit të Prishtinës "Dodona";
11. Propozimvendimet përfundimtare për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës;
12. Të ndryshme.

**KRYESUESI I KOMITETIT**  
**Halim Halimi juri. i dipl.**

*Vërejtje: Luteni që të merrni pjesë në mbledhje. Në rast pamundësie për të marrë pjesë, lajmërohuni në Shërbimin e Kuvendit, në tel. kontaktues:: 038/234-738 & 038/230-900, lok. 1125.*